

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	I hetuar për vrasje, i biri 'zbulon' mashtrimin 14 milionë paund të babait! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/i-hetuar-per-vrasje-i-biri-zbulon-mashtrimin-14-milione-paund-te-babait/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHÀ

KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:33:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:25:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7973c625730d4e66b250eb1fac16f3c63d854d03cac9f18047187443c1733e00
TEKSTI	7825d2b832e1f68f680150856c4076cfda84e7d128d5058132ab79581cef17da
PAMJA	36d470a22985c63397a4d0d5d195146414e30c74516563c88cc70e56687eb051

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d41e532793a92769f6b5cb0dcdea159fd9db73b45cf41856c4532a1baeb3c808
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d41e532793a92769f6b5cb0dcdea159fd9db73b45cf41856c4532a1baeb3c808>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

I hetuar për vrasje, i biri 'zbulon' mashtrimin 14 milionë paund të babait!



Marisa Karabeci

29 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

I sh-ylli i një telenovele televizive, i arratisur dhe i dënua për organizimin e një skeme mashtrimi prej 14 milionë paundësh, u gjurmua dhe u arrestua pasi djali i tij u përfshi në një vrasje në Costa Blanca. Phillip, i cili luajti rolin e Christian Wright në më shumë se 60 episode të serialit të Channel 4, u arrestua në Spanjë të premten e kaluar, pas një kërkimi njëvjeçar. Ai kishte drejtuar për më shumë se tetë vjet një rrjet agjencish të rreme modelingu, duke mashtruar më shumë se 6,000 viktima dhe duke u marrë atyre rreth 13,6 milionë paund.

Një urdhër arresti ishte lëshuar në shkurt të vitit të kaluar, pasi ai ishte dënua në mungesë me tetë vjet e gjashtë muaj burg dhe kishte qenë në arrati që prej atëherë. Pas arrestimit në Alicante, 51-vjeçari, i cili ishte renditur ndër personat më të kërkuar në Britani, pritet të ekstradohet në Mbretërinë e Bashkuar për të vuajtur dënimin.

Policia spanjolle konfirmoi ditën e arrestimit të Philip se ai u kap gjatë një hetimi për një vrasje në të njëjtën zonë bregdetare. Trupi i një 29-vjeçari, i qëlluar me disa plumba, u gjet më 21 dhjetor të vitit të kaluar në një banesë në veri të Torreviejës. Mësohet se për këtë vrasje është bërë një arrestim, por policia besohet se po heton edhe persona të tjerë të dyshuar. Burime pranë hetimit kanë konfirmuar tashmë se djali i Philip, Michael, po hetohej në lidhje me vrasjen. Ishte pikërisht kërkimi për të që çoi hetuesit të vendndodhja ku fshihej babai i tij, ish-aktori i Brookside, në Orihuela Costa.

Vendndodhja aktuale e Michael nuk dihet dhe ai ishte raportuar i zhdukur nga familjarët e shqetësuar në fillim të këtij viti. Një burim tha: "Kur raportuan zhdukjen e tij, kishin frikë se mund të ishte vrarë. Por në atë moment ai tashmë po hetohej në lidhje me vrasjen e dhjetorit." Michael është dënua në mungesë me tre vjet e gjashtë muaj burg në shkurt të vitit të kaluar, për rolin e tij në skemën e mashtrimit të organizuar nga babai i tij. Philip kishte drejtuar një rrjet të dyshimtë agjencish të rreme modelingu dhe kishte marrë në mënyrë të paligjshme gjithsej 14 milionë paund

nga më shumë se 6,000 persona që shpresonin të gjenin punë si modele.

Viktimave u dërgoheshin me email pretendime mashtruese për potencialin e tyre, pasi ishin joshur përmes reklamave të rreme në rrjetet sociale. Mashtrimi u shkaktoi familjeve të tyre borxhe të mëdha. Agjencitë e tij të rreme nuk paguanin taksa dhe mbylleshin e hapeshin vazhdimisht me emra të rinj për t'iu shmangur autoriteteve, u tha në Gjykatën e Kurorës në Sheffield. Policia britanike besohet se u vu në dijeni për herë të parë nga autoritetet spanjolle në fillim të këtij viti se djali i Philip ishte shpallur i zhdukur. Burime nga policia spanjolle konfirmuan se kjo vijon të jetë situata.

Në maj të vitit të kaluar, Agjencia Kombëtare e Krimit (NCA) u bëri thirrje qytetarëve për ndihmë në gjurmimin e Philip, me qëllim që ai të vuante dënimin me burg. Në atë kohë, agjencia deklaroi: “Foster është dënuar për drejtimin e një skeme mashtrimi që përdorte agjenci të rreme modelingu dhe studio fotografike për t'u marrë viktimave shuma të mëdha parash. Viktimave u thuhej se mund të fitonin para si modele profesioniste, por në vend të kësaj u jepeshin fotografi dixhitale me cilësi të dobët, të cilat nuk mund të përdreshin për të siguruar punë profesionale.

Foster kërkohet për të nisur vuajtjen e një dënimi prej tetë vjetësh e gjashtë muaj burg. Nëse keni informacion, kontaktoni Crimestoppers.” Mashtrimi “mizor” i ish-yllit të telenovelave u zbulua pas një hetimi gjashtëvjeçar të kryer nga National Trading Standards (NTS), autoriteti britanik për mbikëqyrjen e standardeve tregtare. Tetë persona të tjerë u dënuan në lidhje me këtë skemë mashtrimi.

LAJME TË NGJASHME



Costa Blanca goditet nga thatësira, njerëzit qëndrojnë në radhë për të mbushur ujë!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



“Villa Sol Lumière”, një oaz paqeje larg kaosit të qytetit!



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



Nga dhoma e hotelit me Guardiolen te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpigjet t'u japë këshilla për dashurinë?



Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën...



“Para nga qielli”/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!




"Patëm një dasmë të madhe shqiptare..." / Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!




Nations League, sonte SHQIPERI vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!

EDITORI SUGJERON



Televizioni hapi i radhës? Amber zbulon ekskluzivisht projektin e ri: Njerëzit duan lumturi, një show që...




"Ku ka më mirë se të kesh një jetë të lirë?" / Amber: Djemtë shqiptarë kanë kompleks...



"Një njeri që ka ndryshuar identitetin..." / Amber Candy: Jam shumë e fortë për t'ia dalë në Shqipëri!



Flirt me ndonjë nga banorët? Amber: Më mirë t'i nxjerr vetë të palarat, se sa të m'i nxjerrin të tjerët...



"Në BBV kupton veten..." / Do të lidhej me një banor brenda shtëpisë? Amber: Unë godas që në fillim!



"Nuk duhet të rihyja, u stepa sepse..." / Amber Candy: Nuk mund të godasësh një banor që është i lodhur...



7 shenja që mund të tregojnë rezistencë ndaj insulinës!



Bëni kujdes! 10 zakone të përditshme që mund të shkaktojnë rritje të sheqerit në gjak...



5 suplemente që mund të mbështesin efektin e ilaçeve për dobësim...



7 ushqime që mund t'i përkeqësojnë efektet anësore nëse jeni duke marrë Ozempic!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontakttoni
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.